



Funded by
the European Union



ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE
KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT
RAPORT MUJOR I MONITORIMIT TË AKTIVITETIT TË KQZ
Mars 2021

Projekti:

“Unë marr pjesë! Zëri im, vota ime vlen” mbështetur financiarisht nga Bashkimi Europian.

Ky raport u prodhua në kuadër të nismës “Unë marr pjesë! Zëri im, vota ime vlen” mbështetur financiarisht nga Bashkimi Europian. Përmbajtja e tij është përgjegjesi vetëm e Komitetit Shqiptar të Helsinkit dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Europian.



Funded by
the European Union



ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE
KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT



Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH), në përmbushje të misionit të tij dhe kryerjes së monitorimit të Zgjedhjeve Parlamentare të 25 Prilli 2021, është i angazhuar në vëzhgimin dhe monitorimin e veprimtarisë së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) dhe organeve drejtuese të tij. Më poshtë, parashtrohet përmbledhja e monitorimit të kryer gjatë periudhës mars 2021.

Përmbledhje Ekzekutive

1. Me vendimin nr. 11 datë 25.03.2021 “Për mënyrën e ngritjes, organizimit, funksionimit të Komisionit të Qendrës së Votimit dhe zhvillimit të zgjedhjeve në Qendrën e Votimit”, KQZ ka parashikuar zbatimin e disa detyrimeve nga administrata dhe subjektet zgjedhore përpara hyrjes në fuqi të aktit në të cilin përcaktohen këto detyrime.
2. Për shkak se pandemia Covid-19 ka vështirësuar monitorimin në terren të procesit zgjedhor, konsultimi i akteve nëpërmjet publikimit në kohë në faqen zyrtare të KQZ-së ndihmon vëzhgimin e procesit zgjedhor nga organizatat vendase dhe ndërkombëtare dhe shërben për të garantuar transparencën e zhvillimit të procesit zgjedhor.
3. Ndërtimi, konsolidimi dhe aksesimi i një rrjeti të personave të trajnuar mbi legjislacionin zgjedhor shërben për t’iu përgjigjur nevojave të mundshme emergjente për zëvendësimin e anëtarëve të KQV-ve, sidomos në prag të datës së zgjedhjeve ku hapësira për të vepruar mund të jetë e kufizuar. Trajnimi më i hershëm në kohë i punonjësve të administratës zgjedhore bëhet më i nevojshëm për shkak të zbatimit të teknologjisë së informacionit dhe sistemit të video-regjistrimit dhe përgatitjes së anëtarëve të KQV-ve për zbatimin e rregullave për administrimin e pajisjeve teknologjike.
4. Vendimmarrje të caktuara në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, të cilat reflektojnë një ndarje të ngushtë midis anëtarëve (3 me 2), përbëjnë një tregues potencial se këto vendimmarrje mund të jenë marrë nën ndikimin e faktorëve politikë.



Funded by
the European Union



ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE
KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT



OSBE/ODIHR vëren në raportet e mëparshme të monitorimit të zgjedhjeve¹ se vendimarrja e ngushtë sipas linjave politike shfaq natyrën e politizuar të diskutimeve të KQZ-së (*sipas strukturës së mëparshme të organit*). Gjithashtu, OSBE/ODIHR vëren se politizimi i vazhdueshëm i organeve dhe institucioneve të lidhura me zgjedhjet ulin besimin e publikut në procesin zgjedhor.

5. Nga hulumtimi i kryer në listat shumemërore të kandidatëve për deputet, rezultojnë kryetarët e 7 subjekteve zgjedhore kanë ushtruar mundësinë e kandidimit në më shumë se një zonë zgjedhore. Në mungesë të vullnetit të subjekteve zgjedhore për të vepruar në përputhje me opinionin e Komitetit Shqiptar të Helsinkit, Komisionit të Venecias dhe OSBE/ODIHR për të mos kandiduar në më shumë se një zonë zgjedhore, sugjerohet të rishikohet pika 3 e nenit 67 të Kodit Zgjedhor, sipas rekomandimeve të marra.
6. Rekomandohet që KQZ të mbikqyrë zbatimin e detyrimit të Kryetarëve të Bashkive për publikimin në faqen e internetit të vendimit për përcaktimin e vendeve publike për afishimin e materialeve propagandistike, qoftë për rastin e Bashkisë Vorë për të cilën tashmë ka një vendimarrje, qoftë për rastet e sinjalizuara në këtë raport (*i.e. Tiranë, Korçë, Elbasan, Durrës*).
7. Me miratimin e vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 148, datë 16/03/2021 “*Për caktimin e Vendeve të Numërimit të Votave, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 prill 2021*”, vërehet se ngritja VNV-ve është administruar në

¹ Raporti Përfundimtar i Misionit të OSBE/ODIHR-it për Vëzhgimin e Zgjedhjeve të Qeverisjes Vendore, 21 Qershor 2015, OSBE/ODIHR, 8 shtator 2015, Varshavë, fq 7 “*natyra e politizuar e diskutimeve të KQZ-së u vu re në shumicën e mbledhjeve të saj. MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it vuri re se, ndërkohë që vendimet mbi çështjet teknike u miratuan shpesh me unanimitet, vendimet mbi çështje më thelbësore u miratuan kryesisht me votim të ndarë katër me tre*”



Funded by
the European Union



ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE
KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT



përputhje me afatet ligjore të parashikuar në Kodin Zgjedhor.

8. Është e rekomandueshme që KQZ të përshkallëzojë fushatën e saj të informimit, në mënyrë që zgjedhësit të njihen me fletën e votimit paraprakisht dhe në rast se vërehet paqartësi nga ana e zgjedhësve, të adresohen në mënyrë të përshtatshme nga KQZ-ja.



Funded by
the European Union



ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE
KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT



Në vijim të këtij raporti, KShH paraqet një analizë më të plotë lidhur me vendimmarrjet që kanë qenë objekt i monitorimit dhe që i përkasin organit më të lartë të administrimit të procesit zgjedhor, KQZ-së.

I. Vendim nr. 11, datë 25.03.2021 “Për mënyrën e ngritjes, organizimit, funksionimit të Komisionit të Qendrës së Votimit dhe zhvillimit të zgjedhjeve në Qendrën e Votimit”

Në zbatim të kompetencave të deleguara nga Kodi Zgjedhor, në nenin 20 të tij, mbi miratimin e rregullave të detajuara për organizimin dhe administrimin e zgjedhjeve dhe detyrat e administratës zgjedhore, Komisioni Rregullator i KQZ-së (Rregullatori) miratoi me datë 25.03.2021 vendimin nr. 11 “Për mënyrën e ngritjes, organizimit, funksionimit të Komisionit të Qendrës së Votimit dhe zhvillimit të zgjedhjeve në Qendrën e Votimit”. Në të përcaktohen procedurat për dorëzimin e propozimeve për anëtarë të KQV-ve, përbërjen dhe emërimin e anëtarëve, përputhshmëria dhe kushtet e pozicionit, shkarkimi dhe zëvendësimi i anëtarëve, detyrat dhe përgjegjësitë dhe rregullat e zhvillimit të procesit të votimit.

Në nenin 9, pika 4 të këtij vendimi të Rregullatorit parashikohet se *në çdo rast emërimi i anëtarëve dhe sekretarëve të KQV-ve bëhet jo më vonë se 20 ditë para datës së zgjedhjeve (i.e. 05/04/2021).* Ndërsa në pikën 5 parashikohet se *KZAZ-ja dërgon menjëherë në rrugë elektronike në KQZ, një kopje të vendimeve për emërimin e anëtarëve, kryetarit dhe sekretarit të KQV-së.* Deri në datën 05/04/2021 që shënon përmbylljen e afatit ligjor të emërimit, vendimmarrja e KZAZ-ve nuk rezultoi të jetë publikuar në faqen zyrtare të KQZ-së. Duke konsideruar rrethanat e diktuar nga pandemia Covid-19 ku monitorimi në terren është vështirësuar, konsultimi i akteve nëpërmjet publikimit në kohë në faqen zyrtare të KQZ-së ndihmon vëzhgimin e procesit zgjedhor nga subjektet vendase dhe ndërkombëtare dhe shërben për të garantuar transparencën e zhvillimit të procesit zgjedhor.

Neni 12, pika 3 e këtij vendimi parashikon se *zëvendësimi i anëtarëve të KQV-së bëhet si rregull me persona të cilët kanë trajnim për legjislacionin zgjedhor.* Mbetet për tu monitoruar se si do të zbatohet kjo dispozitë në praktikë, ndërkohë që vlen të përmendim rekomandimin e



Funded by
the European Union



ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE
KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT



OSBE/ODIHR², që kërkon forcimin e kapaciteteve *profesionale të komisioneve zgjedhore me anë të KQZ-së*, e cila mund të ofrojë rregullisht trajnime me certifikim për anëtarë të mundshëm të KZAZ-ve, KQV-ve dhe grupeve të numërimit, dhe të krijojë një regjistër me personat e certifikuar. Ndërtimi, konsolidimi dhe aksesimi i një rrjeti të personave të trajnuar mbi ligjin zgjedhor shërben për t'iu përgjigjur nevojave të mundshme emergjente, sidomos në prag të datës së zgjedhjeve ku hapësira për të vepruar mund të jetë e kufizuar. Trajnimi paraprak i përfaqësuesve të administratës zgjedhore bëhet më i nevojshëm për shkak të zbatimit të teknologjisë së informacionit dhe sistemit të video-regjistrimit dhe përgatitjes së anëtarëve të KQV-ve për zbatimin e rregullave për administrimin e pajisjeve teknologjike.

2. **Vendimi i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, nr. 156, datë 17.03.2021**
“Për shqyrtimin e kërkesës për regjistrimin e listave shumemërore të Koalicionit “Partia Demokratike-Aleanca për Ndryshim (PD-PR-PDIU-PAA-PBDNJ-PDK-LZHK-PLL-FRD-BLD-PBKD-PBDPKD) për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill 2021”; **Vendimi i KAS nr. 09, datë 23.03.2021 “Për shqyrtimin e Kërkesës Ankimore nr. 05, datë 19.03.2021 të koalicionit Partia Demokratike –Aleanca për Ndryshim (PD-AN) me objekt ‘Kundërshtimin e vendimit nr. 156, datë 17.03.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve’.**

Në pikën I të nenit 67 të Kodit Zgjedhor përcaktohet se *partia politike ose koalicioni zgjedhor, në kuptim të nenit 65, që është regjistruar në KQZ si subjekt zgjedhor për zgjedhjet në Kuvend, depoziton në KQZ listën shumemërore të kandidatëve të tij për çdo zonë zgjedhore jo më vonë se 50 ditë para datës së zgjedhjeve.* Njëpërmjet publikimeve në faqen zyrtare të KQZ-së njoftohet se 9 parti politike dhe 3 koalicione zgjedhore kanë dorëzuar listat shumemërore të kandidatëve për deputet në përputhje me afatin ligjor.

²Raporti Përfundimtar i Misionit të OSBE/ODIHR-it për Vëzhgimin e Zgjedhjeve për Kuvendin 25 Qershor 2017, OSBE/ODIHR, 28 shtator 2017, Varshavë, fq 27.



Funded by
the European Union



ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE
KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT



Në vendimin nr. 156 të datës 17/03/2021, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve shqyrtoi kërkesën e koalicionit PD-AN, përkundrejt kushteve të nenit 67 të Kodit Zgjedhor. Në këtë vendim, Komisioneri paraqet një interpretim të nenit 67, pika 4 i cili parashikon se *numri i kandidatëve në listën shumemërore nuk mund të jetë më i vogël se numri i mandateve që do të zgjidhen në zonën zgjedhore përkatëse, shtuar dy. Në çdo rast, numri i kandidatëve në listën shumemërore duhet të jetë i plotpjesëtueshëm me numrin tre.* Në interpretimin e Komisionerit, paragrafi 4 i nenit 67 të Kodit Zgjedhor përcakton numrin e saktë të kandidatëve që duhet të përmbajnë listat shumemërore të subjekteve zgjedhore. Për rrjedhojë, Komisioneri miratoi listën shumemërore në përputhje me interpretimin e kryer. Në vijim të kundërshtimit të vendimit të Komisionerit nga pala e interesuar, Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve (KAS), nëpërmjet vendimit nr. 9, datë 23/03/2021, rrëzon vendimin e Komisionerit me vendimmarrje të ndarë në 3 vota pro dhe 2 kundër. Në interpretimin e KAS, dispozita e sipërcituar përcakton kufirin minimal të numrit të kandidatëve. Por edhe ky vendim i KAS dhe rrjedhimisht interpretimi i bërë prej tij nuk ishte përfundimtar, pasi Kolegji Zgjedhor, në vendimin nr. 3, datë 29/03/2021, rrëzon vendimin e KAS duke risjellë interpretimin fillestar të dispozitës.

Çfarë vërehet si problematike është dinamika e ndarjes së vendimmarrjes në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, çka mund të sinjalizojë shenja të politizimit të organeve zgjedhore. OSBE/ODIHR vëren në raportet e mëparshme të monitorimit të zgjedhjeve³ se vendimmarrja e ngushtë sipas linjave politike shfaq natyrën e politizuar të diskutimeve të KQZ-së (sipas strukturës së mëparshme të organit). Gjithashtu, OSBE/ODIHR vëren se politizimi i vazhdueshëm i organeve dhe institucioneve të lidhura me zgjedhjet ulin besimin e publikut në procesin zgjedhor⁴.

³ Raporti Përfundimtar i Misionit të OSBE/ODIHR-it për Vëzhgimin e Zgjedhjeve të Qeverisjes Vendore, 21 Qershor 2015, OSBE/ODIHR, 8 shtator 2015, Varshavë, fq 7 “natyra e politizuar e diskutimeve të KQZ-së u vu re në shumicën e mbledhjeve të saj. MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it vuri re se, ndërkohë që vendimet mbi çështjet teknike u miratuan shpesh me unanimitet, vendimet mbi çështje më thelbësore u miratuan kryesisht me votim të ndarë katër me tre”

⁴ Raporti Përfundimtar i Misionit të OSBE/ODIHR-it për Vëzhgimin e Zgjedhjeve për Kuvend, 25 Qershor 2017, OSBE/ODIHR, 28 shtator 2017, Varshavë, fq 1



Funded by
the European Union



ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE
KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT



Në vijim të miratimit të regjistrimit të listave shumemërore të kandidatëve për deputet nga KQZ, mund të vërehet zbatimi në praktikë nga subjektet zgjedhorë i favorizimit ndaj kryetarëve të partive apo partive udhëheqëse të koalicioneve, për të kandiduar deri në katër zona zgjedhore, sipas pikës 3 të nenit 67 të Kodit Zgjedhor⁵. Komiteti Shqiptar i Helsinkit ka kritikuar këtë dispozitë e cila cënon trajtimin e barabartë të kandidatëve, mbështetur në traktatet dhe standartet ndërkombëtare. Gjithashtu, Komisioni i Venecias dhe OSBE/ODIHR, në opinionin e përbashkët mbi ndryshimet e Kodit Zgjedhor të datës 5/10/2020, rekomanduan se udhëheqësit politikë duhet të angazhohen që të vetëpërbahen nga kandidimi në disa zona elektorale dhe që kjo dispozitë duhet të rishikohet pas zgjedhjeve parlamentare 2021⁶. Nga hulumtimi i kryer në listat shumemërore të kandidatëve për deputet, rezultoi se kryetarët e 7 subjekteve zgjedhore⁷ kanë ushtruar mundësinë e kandidimit në më shumë se një zonë zgjedhore. Në mungesë të vullnetit të subjekteve zgjedhore për të vepruar në përputhje me rekomandimet e Komisionit të Venecias dhe OSBE/ODIHR përsa i përket zgjedhjeve për Kuvend të datës 25 prill 2021, i sugjerohet Kuvendit të ri të Republikës së Shqipërisë të rishikojë pikën 3 të nenit 67 të Kodit Zgjedhor, duke garantuar barazi për të gjithë kandidatët në garë, pa asnjë dallim.

3. Udhëzim nr. 06, datë 23.03.2021 “Për përdorimin e materialeve propagandistike e edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore”.

⁵ Kandidati për deputet, i regjistruar në një listë shumemërore në një zonë zgjedhore nuk mund të regjistrohet si i tillë për një zonë zgjedhore tjetër, qoftë edhe për llogari të një partie apo koalicioni tjetër dhe as si i propozuar nga një grup zgjedhësish. Bën përjashtim nga ky rregull kryetari i partisë apo i partisë udhëheqëse të koalicionit, i cili në zgjedhjet për Kuvendin mund të regjistrohet deri në katër zona zgjedhore.

⁶ European Commission for Democracy through Law (Venice Commission) and OSCE Office for Democratic Institutions and Human Rights (OSCE/ODIHR), Joint Opinion on the Amendments to the Constitution of 30 July 2020 and to the Electoral Code of 5 October 2020, Opinion No. 1006/2020, 11/12/2020, faqe 8.

⁷ Partia Balli Kombëtar; Partia Socialiste e Shqipërisë; Partia Nisma Thurje; Partia Lëvizja për Ndryshim; Partia Lëvizja Socialiste për Ndryshim; Partia Lëvizja Demokratike Shqiptare; Partia Socialdemokrate



Funded by
the European Union



ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE
KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT



Kodi Zgjedhor, në nenin 79, pika I parashikon se *jo më vonë se 35 ditë para datës së zgjedhjeve (i.e. 20/03/2021), kryetari i bashkisë, në mënyrë të drejtë dhe të paanshme, përcakton vendet publike në territorin e bashkisë përkatëse për afishimin prej partive politike dhe subjekteve zgjedhore të materialeve propagandistike. Vendimi i kryetarit të bashkisë bëhet publik në faqen e internetit të bashkisë menjëherë pas miratimit. Nëpërmjet hulumtimit të kryer në faqet zyrtare të 9 bashkive (Tiranë, Shkodër, Vlorë, Fier, Korçë, Elbasan, Kukës, Gjirokastrë, Durrës), rezulton se Bashkitë Tiranë, Korçë, Elbasan dhe Durrës nuk kanë të publikuar në faqen zyrtare vendimin për përcaktimin e vendeve publike për afishimin e materialeve propagandistike. Faqja zyrtare e bashkisë Gjirokastrë, për shkak të mosfunksionimit të rregullt, nuk mundëson akses efektiv në këtë informacion. Nëpërmjet vëzhgimit të vendimeve të publikuara të bashkive Shkodër dhe Vlorë vërehet se vendimet janë miratuar, me vonesë gati 9 ditore nga afati ligjor, përkatësisht në datë 29/03/2021, ndërsa vendimet e bashkive Fier dhe Kukës janë miratuar me një vonesë 5 ditore nga afati ligjor, në datë 25/03/2021.*

Në vendimin nr. 140 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, shqyrtohet ankesa ndaj Bashkisë Vorë në Qarkun e Tiranës, për shkelje të parashikuar në vendimin nr. 9, datë 24/12/2020 të Komisionit Rregullator, lidhur me mospasjen e faqes së internetit, me qëllim reflektimin e informacionit dhe vendimeve dhe zbatimin e nenit 79 të Kodit Zgjedhor. Nëpërmjet vendimit, Komisioneri udhëzon Kryetarin e Bashkisë Vorë që të marrë masat e menjëhershme për aksesimin e faqes së internetit. Mospërbushja e detyrimeve passjell aplikimin e sanksioneve të parashikuara në nenin 173 të Kodit Zgjedhor. Nëpërmjet vëzhgimit të kryer nga KShH, vërehet se Bashkia Vorë vijon ende të mos ketë një faqe aktive interneti. Për sa më sipër, KShH i rekomandon KQZ-së të ndjekë në mënyrë sistematike, zbatimin e detyrimit të Kryetarëve të Bashkive për publikimin e vendimmarrjeve lidhur me vendet ku do afishohen materialet propagandistike, qoftë për rastin e Bashkisë Vorë për të cilën tashmë ka një vendimmarrje, qoftë për rastet e sinjalizuara në këtë raport.

4. Vendim nr. 148, datë 16.03.2021 “Për caktimin e Vendeve të Numërimit të Votave, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 prill 2021”.



Funded by
the European Union



ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE
KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT



Lidhur me vendndodhjet e vendeve të numërimit të votave, Kodi Zgjedhor, në pikën I të nenit 94 të tij parashikon se *jo më vonë se 60 ditë para datës së zgjedhjeve, prefekti i qarkut i paraqet KQZ-së listën e plotë të objekteve brenda territorit të qarkut, që përmbushin kushtet e parashikuara në pikat 1 dhe 2 të nenit 93 dhe të këtij neni. Jo më vonë se 40 ditë nga data e zgjedhjeve, KQZ-ja me vendim cakton Vendin e Numërimit të Votave.*

Nëpërmjet njoftimit të KQZ-së, vërehet se prefektët e 12 qarqeve kanë paraqitur në KQZ listën e objekteve për ngritjen e VNV-ve brenda afatit ligjor. Gjithashtu, me miratimin e vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 148, datë 16/03/2021 “Për caktimin e Vendeve të Numërimit të Votave, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 prill 2021”, vërehet se ngritja VNV-ve është administruar në përputhje me afatat ligjore të parashikuara në Kodin Zgjedhor.

- 5. Vendim nr. 12, datë 31.03.2021 “Për shpalljen e moskompetencës së Komisionit Rregullator për shqyrtimin e projektvendimit “Për miratimin e përmbajtjes së fletëve të votimit për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 prill 2021”;**
Vendim nr. 198, datë 01.04.2021 “Për miratimin e përmbajtjes së fletës së votimit për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 prill 2021”.
Vendim nr. 19, datë 03.04.2021 “Për shqyrtimin e kërkesave ankimore nr. 08 të Partisë Socialiste të Shqipërisë, nr. 09 të Partisë Bindja Demokratike dhe nr. 10 të koalicionit Partia Demokratike-Aleanca për Ndryshim (PD-AN) ndaj vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 198, datë 01.04.2021”.

Me datë 1 prill 2021, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve miratoi Vendimin nr. 198 për “Miratimin e përmbajtjes së fletëve të votimit për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 prill 2021”, pasi Komisioni Rregullator kishte shpallur moskompetencën për vendimmarrjen lidhur me fletën e votimit. Teksa neni 20 i Kodit Zgjedhor përcakton kompetencat e Rregullatorit në mënyrë shteruese, nga ana tjetër, neni 19, përcakton kompetencat e Komisionerit, duke parashikuara se ky i fundit ushtron në emër të KQZ-së kompetencat që Kodi Zgjedhor nuk ia



Funded by
the European Union



ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE
KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT



njuh shprehimisht Rregullatorit ose KAS-it. Konflikti i krijuar për kompetencën midis Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe Komisionit Rregullator është një çështje e interpretueshme, megjithatë, pavarësisht se neni 20 i Kodit Zgjedhor, nuk parashikon shprehimisht si kompetencë të Rregullatorit miratimin e përmbajtjes së fletës së votimit, nga ana tjetër kjo vendimarrje ka karakter normativ pasi shtrihet në të gjithë territorin e vendit, dhe neni 20, në pjesën hyrëse të tij ia ngarkon Rregullatorit shqyrtimin dhe miratimin e projekt-akteve me karakter normative, ndërkohë që më pas i specifikon ato, duke mos i dhënë hapësirë për këtë vendimarrje.

Kodi Zgjedhor, në pikën 3 të nenit 98, ka parashikuar se çfarë do të përmbajë fleta e votimit dhe si do të renditen subjektet zgjedhore në të, përfshi këtu orientimin lidhur me vendosjen e siglës, etj⁸. Ndërsa, për përmbajtjen e fletës së votimit përsa i përket votimit të kandidatit/es së preferuar të zgjedhësit (votimi parapëlqyes), ligjvënësi, në nenin 98, pika 4⁹, parashikon se mënyra e votimit parapëlqyes përcaktohet nga KQZ-ja në varësi nga numri i subjekteve pjesëmarrëse në zgjedhje, duke respektuar kushtin që informacioni i përcjellë nga fleta e votimit të mos jetë tejet i ngarkuar, konfigurimi i fletës të jetë i qartë e i kuptueshëm për zgjedhësin dhe zgjedhësi ta ketë të lehtë orientimin për votimin e subjektit zgjedhor dhe të kandidatit të parapëlqyer. Kjo dispozitë i mundëson KQZ-së hapësirë të gjerë vlerësimi dhe rrjedhimisht dhe interpretimi, çka ka reflektuar edhe me kontestime nga subjektet zgjedhore, ku fillimisht është kundërshtuar vendimarrja e Komisionerit në KAS nga subjekti Partia Socialiste e Shqipërisë

⁸ Emrat e subjekteve zgjedhore vendosen në fletën e votimit, sipas rendit të përcaktuar në mënyrë të rastësishme nga shorti. Përbri emrit të partisë vendoset sigla, shkronja nistore dhe emri i kryetarit të partisë. Çdo subjekti që renditet në fletën e votimit i korrespondon hapësira përkatëse për shënimin e votës nga zgjedhësi.

⁹ fleta e votimit për zgjedhjet për Kuvendin duhet të përmbajë hapësirën e posaçme për ushtrimin e votimit parapëlqyes për kandidatët e subjektit zgjedhor. Mënyra e votimit parapëlqyes përcaktohet nga KQZ-ja në varësi nga numri i subjekteve pjesëmarrëse në zgjedhje, duke respektuar kushtin që informacioni i përcjellë nga fleta e votimit të mos jetë tejet i ngarkuar, konfigurimi i fletës të jetë i qartë e i kuptueshëm për zgjedhësin dhe zgjedhësi ta ketë të lehtë orientimin për votimin e subjektit zgjedhor dhe të kandidatit të parapëlqyer.



Funded by
the European Union



ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE
KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT



dhe më pas, është kundërshtuar vendimmarrja e KAS në Kolegjin Zgjedhor nga subjekti Partia Demokratike.

Në këtë drejtim, Kodi Zgjedhor mund të ishte më i qartë dhe orientues për organet e administrimit zgjedhor, ndërkohë që mbetet për tu parë se sa të orientuar dhe të qartë do të jenë vetë zgjedhësit për të votuar kandidatin/en e tyre të preferuar në këto zgjedhje parlamentare. Vlefshmëria e fletëve të votimit, të paktën në ato raste kur vetë zgjedhësit nuk kanë si qëllim për ta deklaruar të pavlefshme, është një element i rëndësishëm i mbarëvajtjes së procesit zgjedhor, ndaj, KShH i rekomandon KQZ-së të përshkallëzojë fushatën e saj të informimit, në mënyrë që zgjedhësit të njihen me fletën e votimit paraprakisht dhe në rast se vërehet paqartësi nga ana e zgjedhësve, të adresohen në mënyrë të përshtatshme nga KQZ-ja. KShH e ka adresuar çështjen e fushatës së informimit në raportin e monitorimit të KQZ-së për muajin janar.